



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kacanik

01– Nr. 05-400-24297/12.
Kaçanik; 27. 09. 2012.

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61. të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur të ekzekutivit Komunal më 27.09. 2012, merr;

V E N D I M

PËR BUXHETIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN FISKAL 2013 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2014 - 2015

1. Buxheti total i Komunës së Kaçanikut për vitin buxhetor 2013 është në shumë prej 5,611,059 €, ndërkaq për vitin 2014 vlerësimet e projektuara janë në masë monetare prej 5,716,994 € dhe për vitin 2015 në shumë prej 5,771,708 €.

2. Në strukturën e të hyrave të përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2013, sipas pikes I. të këtij vendimi, mjetet nga Grantet qeveritare janë në shumë prej 5,011,059 €, që shëojnë pjesmarrje me 89,3% dhe të hyrat vetjake komunale, në shumë prej 600,000 € me një pjesmarrje prej 10,7% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.

3. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2013, parashikohen që të jenë të ndarë për Shpenzime Operative, shuma prej 4,517,897 € dhe për Investime Kapitale, shuma prej 1,093,162 €.

4. Shpenzimet buxhetore për vitin 2013, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, do të kenë këtë ndarje:

▪ Pagat dhe Mëditje	3,743,672 €
▪ Mallërat dhe Shërbimet	535,468 €
▪ Shërbimet Komunale	108,757 €
▪ Subvencionet dhe Transferet	130,000 €
▪ Investimet Kapitale	1,093,162 €

5. Për zbatimin dhe rishikimin e këtij vendimi për buxhetin e komunës, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i komunës,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi